

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Korçë, më 13.10.2025

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Blerje shërbimi për instalim dhe konfigurim firewall, router, switch”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** Paketa software për switche ose rutera: 48219500-1.

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 7.810.000 (shtatë milion e tetëqind e dhjetë mijë) Leke pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë Sh.A (UKRK Sh.A), ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3, me vlerë **156.200 (njqind e pesedhjetë e gjashtë mijë e dyqind) Lekë** (2% të vlerës së përlllogaritur të kontratës).

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 10.

L. Duka

K. Bojko

E. Bicolli

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 77, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar.

**2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare 2022, 2023, 2024 ku

vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 3.124.000 (tre milion e njëqind e njëzet e katër mijë) Lekë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 germa c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndyshime.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet bazuar në dispozitat e sipërpërmendura ku përcaktohet:

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: **c) “40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”si dhe sipas parashikimit të nenit 55 të Rregullave të PP.**

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Ajo i shërben UKRK Sh.A , për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.

*Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).*

L. Duka

K. Bojko

E. Bicolli

### **3. Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 1.562.000 (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë) Lekë pa TVSH.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të

plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” me ndryshime. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4/b të Rregullave të PP ku përcaktohet shprehimisht, citojmë:

"Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës."

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën si më sipër, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar ( $20\% \times 7.810.000 \text{ Leke} = 1.562.000 \text{ Leke}$ ). Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor UKRK SH.A., për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjesëtim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës siç është parashikuar nga AK.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

K. Bojko

**3.2.** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatat që vërtetojnë përputhshmërinë me standardet:

- **ISO 9001:2015**, Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalent e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmërisë.

- **ISO 27001-2022**, Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë Informatike ose ekuivalent e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmërisë.

- **ISO 20000-1:2018**, Sistemi për Menaxhimin e Shërbimeve ose ekuivalent e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmërisë.

Certifikatat duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH, ose ekuivalente me to.

**Argumentim:** Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

*Sqarojmë se Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A, operon në një fushë që është shumë specifike dhe te ndjeshme për publikun dhe kërkon nga operatorët ekonomike që bashkepunon që të veprojnë sipas standardeve në fuqi. Objekti i prokurimit ka të bëjë me infrastrukture network dhe sigurie.*

*Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron që operatori zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilesor të tij.*

*Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit siguron që operatori ekonomik aplikon, mirëmban dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme një përfaqje sistematike në menaxhimin e informacionit sensitiv me fokus tek siguria.*

*Menaxhimi i shërbimit IT siguron që operatori ekonomik ka të implementuar një sistem ofrimi të shërbimit përmes të cilit efektisht planifikon, implementon, operon, monitoron, kontrollon dhe mirëmban portofolin e shërbimeve dhe cilësinë e tyre.*

**3.3.** Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe në cilesi, operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka të paktën 2 (dy) punonjës, të cilët ne menyre të kombinuar, të plotësojnë kërkesat për certifikime si më poshtë:

**Shënim:** Për këtë pikë operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e VETËDEKLARIMIT sipas shtojcës nr. 10.

*Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*

*Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.*

Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë të gjithë stafin dhe personelin e tij tekniko-profesional, i cili do të angazhohet në shërbimet e kërkuara të mirembajtjes. Në përbërje të stafit Operatori Ekonomik duhet të ketë minimalisht stafin e mëposhtëm;

a) Të paktën 1 (një) specialist i certifikuar nga prodhuesi i switch, për rrjetin ose ekuivalent.

**Argumentim:** Duke qenë se pajisja switch do të sigurojë komunikimin IP (Internet Protocol) të Autoritetit Kontraktor është i nevojshëm 1 specialist i certifikuar nga prodhuesi ose ekuivalent për këtë teknologji.

b) Të paktën 1 (një) specialist i certifikuar nga prodhuesi fusha “Security/Siguria” ose ekuivalent.

**Argumentim:** Duke qenë do të implementohet një sistemi sigurie Firewall NG.Router dhe Sistem Autentikimi me faktor të shumefishtë (MFA) dhe duke patur parasysh rendesine e këtij sistemi për mbarevajtjen e kontrates, duhet që të jete 1 specialist i certifikuar nga Prodhuesi ose ekuivalent për këtë teknologji.

Personeli i mesiperm duhet të ketë aktualisht një marrëdhënie pune me ofertuesin jo më pak se 1 (një) muaj, e vertetuar kjo me formularët E-sig të listepagesave të deklaruara dhe të firmosura nga inspektorët tatimore. Afesite e tyre teknike duhet të vertetohen me ane të certifikatave ose transkriptëve (në rastin kur aplikohet) të leshuara nga prodhuesi.

**Shenim:** Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi fitues përpara dhënies së kontratës (Sipas pikës 1 dhe pikës 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar). Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara lidhjes së kontrates, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

**Argumentim:** Kriteret e mësipërme janë në përputhje me parashikimet e neni 41 pika 4 dhe pika 6 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) parashikohet se: “a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të leshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose” “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”

**Shenim:** Lidhur me termin “ne menyre te kombinuar” shprehemi se ky term lidhet me numrin e stafit te kerkuar dhe licensimet e tyre nga te cilet secili nga stafi i oe mund te kete me shume se nje certifikim dhe mund te mbuloje me shume se nje detyre te caktuar.

***Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre.***

*Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.*

*Operatorët e huaj ekonomikë, duhet të paraqesin të gjithë dokumentat e tyre në gjuhën shqipe ose anglisht, të bëjnë noterizimet përkatëse, të jenë të certifikuara “Apostille” dhe të perkthyer në gjuhën shqipe nga perkthyes i licencuar. Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, “Për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja”, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrtarë respektive nga vendi i origjinës. (Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues).*

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

**Ky projekt konsiston ne ndryshimin e infrastrukture network pa nderprere sherbimet perkatese dhe implementimin e nje sistemi sigurie bashkekohor. Bazuar ne te jane bere specifikimet teknike perkatese duke bazura ne kerkesa funksionale dhe performace sipas nevojave te sistemit.**

**Shënim:** *Përcaktimi i specifikimeve teknike, pjesë e DST ngarkuar ne SPE, për shërbimin objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

**Kujdes:** *Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

**Kërkohen shërbimet:** “Blerje shërbimi për instalim dhe konfigurim firewall, router, switch”

**Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë Sh.a.,** është shoqëri e cila operon në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe menaxhimit të ujërave të ndotura në rajonin e Korçës. Shoqëria ka për detyrë garantimin e shërbimeve cilësore për furnizimin dhe shpërndarjen e ujit të pijshëm, si dhe për trajtimin dhe largimin e ujërave të ndotura, duke respektuar standardet mjedisore dhe teknike.

Për të siguruar një infrastrukturë të qëndrueshme dhe të sigurt të rrjetit të saj informatik, SH.R.U.K Korçë Sh.a., synon të realizojë blerjen e një shërbimi për instalimin dhe konfigurimin e firewall-it, router-it dhe switch-it. Ky investim është i domosdoshëm për të përmirësuar sigurinë kibernetike, për të optimizuar trafikun e rrjetit dhe për të garantuar një funksionim më efikas të sistemeve të brendshme.

## **Firewall**

Firewall-i është një pajisje ose program që kontrollon dhe filtron trafikun hyrës dhe dalës të rrjetit bazuar në politika të caktuara sigurie. Ai mbron rrjetin nga sulmet e jashtme, duke parandaluar hyrjen e paautorizuar dhe duke siguruar komunikime të sigurta.

## **Router**

Router-i është një pajisje që lidh rrjete të ndryshme dhe menaxhon trafikun e të dhënave midis tyre. Ai përdor adresa IP për të përcaktuar rrugën më të mirë për të dërguar paketat e të dhënave drejt destinacionit të tyre. Router-at gjithashtu mund të lidhin rrjetet lokale (LAN) me internetin.

## **Switch**

Switch-i është një pajisje rrjeti që lidh pajisjet brenda një rrjeti lokal (LAN) dhe i mundëson atyre të komunikojnë drejtpërdrejt. Ai përdor adresat MAC për të dërguar të dhëna drejt pajisjes së duhur, duke përmirësuar performancën dhe efikasitetin e rrjetit.

## **1. OBJEKTIVAT, QELLIMI DHE REZULTATET E PRITURA**

### **1.1. Objektivi i Pergjithshem**

Objektivi i kesaj procedure eshte zevendesimi i infrastruktures se rrjetit dhe sigurise per Shoqërinë Ujësjiellës Kanalizime Rajoni Korçe si dhe shtimi i sigurise per aksesimin e sistemit te faturimit Al-Billing.

### **1.2. Qellimi**

Nepermjet kesaj procedure Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Rajoni Korçe synon te adresoje zgjidhjen e pikave te meposhtme:

a) Garantimin e vazhdimësisë së shërbimit duke bërë zëvendësimin e pajisjeve të rrjetit me pajisje të reja që suportohen nga prodhuesit perkates. Ky zëvendësim duhet të kryhet duke ruajtur konfigurimet ekzistuese të rrjetit në mënyrë që të sigurohet mos ndërprerje e shërbimeve gjate implementimit te pajisjeve te reja.

b) Përmirësimin e Infrastruktures se sigurise me implementimin e Next Generation Firewall dhe implementimin e nje sistemi autentikimi me factor te shumefishte MFA (Multifactor Autentication) dhe implementim ne sistemin e faturimit Al-Billing.

## 2. LOGJISTIKA DHE KOHA

### 2.1 Vendndodhja

Furnizimi dhe shërbimet e implementimit do të kryhet pranë ambienteve të Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Rajoni Korçe.

### 2.2 Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Furnizimi i pajisjeve dhe implementimi perkates do të kryhen brenda një afati 4 (kater) mujor nga nënshkrimi i kontratës.

## 3. GRAFIKU I FURNIZIMIT TE MALLRAVE DHE SHERBIMEVE

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Switch 48 portesh	cope	1
2	Firewall NG	cope	2
3	Sistemi i Autentifikimit me Faktor të shumefishte (MFA)	cope	1
4	Implementimi i pajisjeve të mesiperme	muaj	4
5	Garancia dhe suporti për pajisjet	vite	1

**Shënim:** Zeri “Implementimi i pajisjeve” përfshin vendosjen, instalim të pajisjeve dhe konfigurimin e tyre.

Zeri “Garancia dhe suporti për pajisjet” përfshin garancinë e pajisjeve të implementuara nga OE në rastin e mosfunksionimit të një pajisje ose në rastin e dëgjies së pajisjes, OE ofron garancinë për zëvendësimin dhe konfigurimin e pajisjes. Suporti 1 vjeçar i dhënë nga OE përfshin ndjekjen/suportin që OE do të japë për pajisjet në rast shfaqjeje të problematikave lidhur me konfigurimet e pajisjesve. Kjo me qëllim e mbarëvajtjen e procesit të punës së AK.

## 4. KERKESAT TEKNIKE

Në kuader të përmirësimit të infrastruktures ekzistuese të rrjetit, kerkohet nga Operatori Ekonomik të ofrojë pajisjet me konfigurimet si më poshtë dhe shërbimin e integritit dhe optimizimit të tyre në infrastrukturen ekzistuese duke ruajtur të pandërprere shërbimin e sistemeve të tjera tona:

### 1. Switch 48 portesh - 1 cope



Nr. Portave dhe moduleve	<p>Nderfaqet e integruara:</p> <p>Min 48 porta 10/100/1000Mbps</p> <p>≥ 4x10G/1G SFP+ uplinks</p> <p>≥ 1 USB 2.0 slot</p>
Performanca	Throughput ≥ 170 Gbps
Forwarding rate	≥ 120Mpps
DRAM	≥ 8 GB DDR4
FLASH	≥ 16 GB
Tensioni nominal	AC (50-60 Hz)
Layer 3 routing	Layer 3 routing LLDP, PBR, MACsec-128 , SXP, IP SLA Responder, SSO, RIP, EIGRP Stub, OSPF
Protokollet e layer 3	<p>Address Resolution Protocol (ARP)</p> <p>Dynamic Host Configuration Protocol (DHCP)</p> <p>User Datagram Protocol (UDP)</p> <p>Transmission Control Protocol (TCP)</p>
Siguria	<p>Layer 2 dhe Layer 3 Access control list (ACL)</p> <p>Network address translation (NAT)</p> <p>STORM-CONTROL</p> <p>Generic Routing Encapsulation (GRE)</p> <p>Secure Shell (SSH) v2/v3 Protocol,</p> <p>SNMPv2/v3</p> <p>Dynamic ARP</p> <p>ICMP</p>

Menaxhimi	CLI Menaxhimi i sigurise se aksesit bazuar ne role SNMPv1, v2, dhe v3 Remote monitoring (RMON) Network Time Protocol (NTP)
Te tjera:	Quality of Service (QoS) IEEE 802.3ad
I montueshem ne rack	
Garanci hardware nga prodhuesi dhe suport per softwaret me nivel kontrate sherbimi 8x5xNBD	3 vite garanci per hardware dhe suport per software. Ofrohet mundesia per te pare dhe hapur trouble ticket me qendren ne cdo kohe (8x5) me suportin e autorizuar te prodhuesit te pajisjes permes e-mail, telefon ose web.

**Shpjegim lidhur me garancine hardware:** Tek të gjitha faqet zyrtare te Switche-ve ofrohet garancia dhe suport 3 vjecar. Garancia/suporti siguron që prodhuesi ose distributori të ofrojë garanci, azhornime firmware për të paktën 3 vite.

AK kërkon që suport 3 vjecar të paraqitet nga OE së bashku me ofertën e tij ndërkohë kjo garanci 3 vjeçare do të mundësohet nga prodhuesit/distributori i pajisjeve nëpërmjet OE.

OE që merr pjesë në këtë procedurë duhet të garantojë që pajisja që po ofron, ka suportin e kërkuar nga vetë prodhuesi (jo thjesht support lokal nga vete OE).

OE duhet të marrë pajisjet nga një distributor i autorizuar nga vetë prodhuesi. Distributori i autorizuar i jep OE pajisje të regjistruara dhe të vlefshme per support zyrtar.

Do të thotë që vetë prodhuesi i Switch duhet të të japë akses në dokumentin teknik zyrtar online, hotfix (ndryshime emergjente që rregullojnë problem të rëndësishme) dhe përditësime firmware (upgrade të softit të brendshëm).

Suport teknik zyrtar do të thotë që pajisja të jetë e regjistruar nga prodhuesi dhe ne si AK të kemi të drejtën të hyjmë vetë në llogarinë e krijuar për në portalin zyrtar të kompanisë për shkarkim manualesh, shakarkim përditësimesh, marrje support zyrtar (asistence online).

Sa më sipër AK kërkon blerjen e suportit nga prodhuesi të siguar nga OE i cili siguron mundësinë për akses në dokumentacion e faqeve zytare.

## 2. Firewall NG - 2 cope

<b>Numri i portave</b>	<p>Min 16 porta RJ-45 10/100/1000</p> <p>Min 2 slote SFP +</p> <p>1 porta Menaxhimi RJ45</p> <p>1 porte Menaxhimi Console</p> <p>2 burime ushqimi te integruar</p> <p>Memorie te brendshme min 400 GB SSD</p>
<b>Kapaciteti hardware</b>	<p>Nuk duhet te kete kufizim ne numer licensat per feature te tilla si Firewall, VPN, AV, IPS, control aplikimesh, numri I pajisjeve ose userash</p> <p>Suporton Virtualizimin, ndarje e pajisjes fizike ne disa domaine virtuale. Secili domain mund te punoje ne menyre te pavarur ne menyre Gateway/NAT ose Transparent/Bridge.</p> <p>Mundesesi per te rezervim te burimeve fizike dhe logjike per domain virtual.</p>
<b>Throughput I Firewall</b>	≥ 10 Gbps
<b>Throughput IPsec VPN</b>	≥ 8 Gbps
<b>Throughput SSL-VPN</b>	≥ 2 Gbps
<b>Throughput IPS</b>	≥ 5 Gbps
<b>Lidhje te njekosishme</b>	≥ 2 Million TCP
<b>Lidhje te reja /seconde</b>	≥ 250,000 TCP
<b>Siguria</b>	
	<p>Web proxy (transparent dhe Explicit)</p> <p>WAN Optimization &amp; Web Caching</p>

	<p>VPN duke perfshire IPsec, L2TP over IPsec dhe PPTP</p> <p>Aksesi SSL VPN nepermjet web portal, bookmarks manager dhe single sign-on per perdoruesin fundor te web applications</p> <p>Intrusion Prevention System me signature te ndara ne baze kategorie dhe risku</p> <p>Kontrolli i aplikimeve ku perfshihen Botnet, Email, File Sharing, Network Services, P2P, proxy services, Remote access, Social Media, Storage, Video/Audio ,VoIP.</p> <p>Suport per aplikimet si SPDY, SSH dhe pershtatja e signatureve sipas kerkeses.</p> <p>Mbrojtja Anti-malware duhet te jete me IP Reputation, Antivirus per HTTP/HTTPS, SMTP/SMTSPS, POP3/POP3S, IMAP/IMAPS, MAPI, FTP, SFTP, SMB, NNTP ,Heuristics analysis, file submission</p> <p>Web Filtering duhet te perfshije kerkimin e sigurte, Java/ActiveX dhe filtrimi Cookie filtering, HTTP Post filtirm, mundesia per te shtuar perjashtime per permbajtje private ;</p> <p>DLP engine me support per HTTP-POST/GET, SMTP, POP3, IMAP, MAPI, FTP; filtra bazuar ne permbajtje, lloj/permase.</p> <p>Update ne kohe reale per kategorizimin Web dhe Antispam (cloud database)</p>
<b>Networking</b>	IPv4/IPv6, suporton DHCP, DNS, VLANs, RIP, OSPF, ISIS, BGP, Multicast, ICAP, QoS dhe NAT46/64
<b>Manaxhimi</b>	<p>Web GUI</p> <p>Suporton administrim dhe raportin te centralizuar</p>

	Administrimi i bazuar ne role
<b>Disponueshmëri e lartë</b>	HA (A-P, A-A, clustera virtual), duke perfshire shperdarjen gjeografike
<b>Garancia/suport</b>	1 vit, Garanci hardware nga prodhuesi dhe suport per softwaret me nivel kontrate sherbimi 8x5xNBD

### 3. Sistemi i Autentifikimit me Faktor te shumefishte (MFA) - 1 cope

Per te siguruar nivel me te larte sigurie kerkohet nje sistem MFA me karakteristikat e meposhtme:
- te lidhet me firewalle ne menyre automatike
- te jete i licensuar ne menyre perpetuale per 200 usera
- Detajet e hyrjes janë shtyrë në telefon për një trokitje miratimi
- Çertifikuar për sigurinë e aplikacionit celular për pajisjet Android dhe iOS
- Transferim i patentuar i tokenit me platformë të kryqëzuar
- Aplikacion i mbrojtur me PIN/Gjurmë gishtash
- Kopjimi OTP në clipboard
- Afishimi i intervalit kohor OTP
- Shfaqja e numrit serial
- Menaxhimi i shenjave dhe aplikacioneve.
- Vetë-fshirja e mbrojtjes nga forca brutale
- Përputhshmëria e orës së Apple
- Integrimi i MFA ne systemin e faturimit AI-Billing
- Izolimimi e rrjetit te percaktuar per aplikimin e WAMR (nepermjet virtualizimit, ndarjes se pajisjeve fizike)

### SUPOZIMET DHE RRISQET

## **Supozimet e Shërbimit**

Realizimi i këtij shërbimi bëhet nën supozimin që do të ketë një përfshirje totale të faktorëve kyç ne “Blerje, instalim dhe konfigurim firewall, router, switch” Përfshirja e plotë e aktorëve kyç është thelbësore për mbarëvajtjen me sukses të shërbimit.

## **Rrisqet**

Mos përfshirja e të gjithë aktorëve kyç do të sjellë mangësi në mirëmbajtjen dhe përmiresimin e sistemeve e si pasojë të ndikojë në sigurinë, punën dhe proceset e SHRUKK.

**Afatet e ekzekutimit të shërbimeve: 4 (kater) muaj, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.**

**Klea Bojko**